



AKTIVITETI VJETOR 2024
KËSHILLI BASHKIAK HAS

RAPORTI I PERFORMANCËS SË KËSHILLIT BASHKIAK HAS 2024

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues, mbikëqyrës dhe vendimmarrës i vetëqeverisjes vendore, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës, ligjshmërisë, duke përdorur me ekonomi dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore si dhe teknologjike të bashkisë. Veprimtaria e Këshillit Bashkiak mbështetet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligjet, aktet nënligjore në zbatim të tyre si dhe rregulloret e miratuara nga vet këshilli, si më poshtë: 1. Ligji ligjin Nr.139/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” 2. Ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”. 3. Ligji nr. 8480 date 27.5.1999, “Për Funksonimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike. 4. Ligji nr. 115 datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. 5. Ligji nr.107 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”. 6. Ligji nr. 119 datë 18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit”. 7. Ligji nr. 146 datë 30.10.2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. 8. Ligji nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. 9. Ligjinr. 9367 datë07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave”,i ndryshuar. 10. Ligji nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” 11. Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.22 datë 25.02.2020 “Për miratimin e rregullores së Organizimit dhe të Funksonimit të Këshillit Bashkiak Has”.

REALIZIMI I FUNKSIONIT VENDIMMARRËS

Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak përcaktohen në nenin 54 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore si dhe ligje të tjera. Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca: a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet; b) zgjedh, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit dhe i shkarkon ata; c) emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit bashkiak; ç) miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi; d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijojnë vetë ose me të cilët është bashkëthemelues; dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë; e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve; ë) organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të bashkisë; f) vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi; g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve; gj) vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë; h) vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet; i) zgjedh përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut, të cilët, në jo më pak se 50 për qind të tyre, duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar; j) vendos për dhënien ose deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 49 të këtij ligji; 4 k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik; l) vendos për simbolet e bashkisë; ll) vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë; m) jep tituj nderi dhe stimuj; n) vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit, me të cilin bëhet ky delegim të bashkia.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2024, Këshilli Bashkiak Has ka realizuar 12 mbledhje radhe dhe vetëm 1 mbledhje jashtë radhe. Në këto mbledhje janë marrë gjithsej 95 vendime.

JANAR 2024.

Në muajin Janar është mbajtur mbledhja e rradhës me datë **29/01/2024**. Është miratur projekt-vendimi për disa ndryshime të pagave për Administratorët e Njësive Administrative. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Dhjetor 2023 ,gjithsej 183 familje me një fond 981,307 lekë. Janë miratur kriteret për familjet që trajtohen me fondin deri në 6% për vitin 2024. Është miratur lista për trajtimin me bonus strehimi për disa qytetarë dhe vlera maksimale e subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë. Janë miratur kërkesat në parim për privatizimet, objekti "Ish Ambulanca Vjetër" nga qytetari z. Fatmir Peka. Objekti "Zyrat e ish sek. Nd. Ndërtimit Krumë" nga qytetari z. Halil Peka, Krumë. Është miratur projekti i emergjencave civile për disa familje që kanë banesat e dëmtuara nga fatkeqësi natyrore. Është miratur një shtesë në Buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2024. Janë miratur kërkesa për ndihmë financiare të qytetarëve : Enver Mazrreku, Ilir Maçi, Beqir Vata, Arben Brati, Isuf Gjoni. Janë trajtuar disa kërkesa të qytetarëve.

SHKURT 2024.

Në muajin Shkurt është mbajtur mbledhja e rradhës me date **26/02/2024**. Është miratur betimi i këshilltarit z. Shefqet Dauti. Është miratur raporti i monitorimit të buxhetit të vitit 2023. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Janar 2024 ,gjithsej 181 familje me një fond 964,535 lekë. Nuk është miratur lista për trajtimin me bonus strehimi për disa familje që nuk përballojnë qiranë e tregut të lirë. Është miratur kërkesa e kryepleqësisë e sjellë nga kryeplaku z. Sokol Dida.

MARS 2024.

Në muajin Mars është mbajtur mbledhja e rradhës me date **27/03/2024**. Është miratur raporti mbi punën e Këshillit Bashkiak Has për vitin 2023. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Shkurt 2024 ,gjithsej 182 familje me një fond 975,999 lekë. Është miratur plani i masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor. Është miratur lista për trajtimin me bonus strehimi për disa qytetarë dhe vlera maksimale e subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë. Është miratur kërkesa për ndihmë financiare emergjente për qytetarin Sulejman Brati. U trajtuan disa kërkesa të qytetarëve

PRILL 2024.

Në muajin Prill është mbajtur mbledhja e rradhës me date **30/04/2024**. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Mars 2024 ,gjithsej 177 familje me një fond 941,906 lekë. Është miratur kërkesa për ri-emërtimin e shkollës Nikoliq me emrin "Jakup Istrefi". Është miratur projekti "Për miratimin e 15 vende pune me kohë të pjesëshme në ofrimin e shërbimeve të ndryshme pranë Bashkisë Has për vitin 2024. Është miratur një ndryshim në Buxhetin e Bashkisë për vitin 2024. Është miratur kërkesa për dhënie pëlqimi në parim për marrjen në përdorim të tokës për ndërtimin e një centrali elektrik fotovoltaiq të Perollaj energy

sh.p.k. Është miratuar kërkesa për ndihmë financiare emergjente për qytetarin Shaqir Kraja. U trajtuan disa kërkesa të qytetarëve.

MAJ 2024.

Në muajin Maj është mbajtur mbledhja e rradhës me date **27/05/2024**. Është miratuar raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e pare për vitin 2024. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Prill 2024 , gjithsej 184 familje me një fond 964,929 lekë. Është miratuar kërkesa në parim “Rehabilitimi dhe sistemimi i Përroit të Vrellës”, dhe kërkesa “Rehabilitimi i rrugëve: Rruga e Rrafshit, Rruga Pashtrikut, Rrugët lagje Sheta, Geca, Peçak, Sistemimi i Përroit të Tershenes”. Është miratuar kërkesa për ndihmë financiare emergjente për qytetaren zj, Valdete Mazrreku . U trajtuan disa kërkesa të qytetarëve.

QERSHOR 2024.

Në muajin Qershor është mbajtur mbledhja e rradhës me date **26/06/2024**. Është miratuar procesverbali I mbledhjes së muajit Maj të dates 27/05/2024. Është miratuar dorëheqja e këshilltarit z. Ilir Çela. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Maj 2024, gjithsej 182 familje me një fond 949,344 lekë. Është miratuar kërkesa për ndihmë financiare emergjente për qytetaret Xheladin Meshi, Kadri Shuti, Ideal Gradica. Është miratuar kërkesa e këshilltarëve për rishikimin e vendimit që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka sjellë rreth mbylljes së spitalit “Haxhi Derri” Krumë, Has.

KORRIK 2024.

Në muajin Korrik është mbajtur mbledhja e rradhës me date 29/07/2024. Janë miratuar projekt-vendimet **1.** Rishpërndarje dhe sistemim në Buxhetin e Bashkisë për vitin 2024. **2.** Miratimi i Programit Buxhetor AfatMesëm (PBA) 2025-2027. **3.** Ndryshim në strukturën organizative të Bashkisë Has të miratuar me urdhër nr.35. Datë 15/01/2024. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Qershor 2024 gjithsej 188 familje me një fond 977,322 lekë. Është miratuar lista për trajtimin me bonus strehimi për disa qytetarë dhe vlera maksimale e subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë. Janë trajtuar disa kërkesa të qytetarëve.

GUSHT 2024.

Në muajin Gusht është mbajtur mbledhja e rradhës me date 27/08/2024. Është miratuar betimi i këshilltares zj, Blerina Çela. Është miratuar projekt vendimi Rishpërndarje e transfertës sektoriale për rritjen e pagave. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Korrik 2024 gjithsej 185 familje me një fond 952,373 lekë. Janë miratuar disa kërkesa të qytetarëve.

SHTATOR 2024.

Në muajin Shtator është mbajtur mbledhja e rradhës me date 25/09/2024. Janë miratuar projekt-vendimet **1.** Rishpërndarje dhe sistemim në Buxhetin e Bashkisë për vitin 2024. **2.** Rishpërndarje e fondit për rritjen e pagave. **3.** Miratimin e pagesës së ndihmës së menjeherëshme për shpenzime transporti fëmijë autik. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Gusht 2024 gjithsej 182 familje me një fond 928,141 lekë. Është miratuar projekti i

emergjencave civile për 1 qytetar Imer Elez Meshi që ka banesën e dëmtuar nga fatkeqësi natyrore .Janë miratuar disa kërkesa të qytetarëve.

TETOR 2024.

Në muajin Tetor është mbajtur mbledhja e radhës me date 24/10/2024.Janë miratuar projekt-vendimet **1.** Rishpërndarje dhe sistemim në Buxhetin e Bashkisë për vitin 2024. **2.** Raportimi i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë 2024. **3.** Për disa ndryshime në VKB-në 34,date 22/12/2023 “Për klasifikimin e pagave të administrates së Bashkisë,institucioneve në vartësi dhe Njësi Administrative për vitin 2024,Bashkia Has, sipas VKM-së nr.503 datë 01/08/2024. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Shtator 2024 gjithsej 183 familje me një fond 935,779 lekë. Është miratuar projekti i emergjencave civile për 2 qytetaret Rexh Lushi & Fatime Lushi për dëmtimin në banesë nga rënie zjarri si dhe dhënie të ndihmës financiare për dy rastet e humbjes së jetëve si pasojë e zjarrit të rënë në shtëpinë e tyre. Është miratuar projekt vendimi për Linjat e transportit për nxenesit dhe mesuesit për vitin 2024-2025.

NËNTOR 2024.

Në muajin Nëntor është mbajtur mbledhja e radhës me date 14/11/2024.Është miratuar projekt vendimi Rishpërndarje dhe sistemim buxheti për zbatimin e VKB 121 date 24.10.2024. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Tetor 2024 gjithsej 183 familje me një fond 925,067 lekë. Është miratuar kërkesa për dhenie pëlqimi në parim për marrjen në përdorim të tokës për ndërtimin e një centrali fotovoltaik nga shoqëria "Pashtriku Power" sh.p.k. Nuk është miratuar Kërkesa për miratimin e heqjes nga fondi pyjor të sipërfaqes prej 2 HA për ushtrimin e aktivitetit minerar gurore, deri në plotësimin e dokumentacionit. Është miratuar kërkesa e raportit teknik-ekonomik për ndërtimin e rrugës nderkufitare Pogaj-Goruzhup. Është miratuar projekt vendimi për bursat e shkollave profesionale.U mor vendim për zaptimin e tokave shtetërore nga individë të ndryshëm.

DHJETOR 2024.

Në muajin Dhjetor është mbajtur mbledhja e radhës me date 23/12/2024.Është miratuar **P-V** sistemimi I taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2025.Është miratuar **P-V** Për numrin e punonjësve të Bashkisë ,institucioneve në varësi,njësi Administrative dhe klasifikimi i pagave të administrates dhe punonjësve të tjerë për vitin 2025.Bashkia Has. Është miratuar **P-V** Buxheti Bashkisë Has për vitin 2025. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Nëntor 2024 gjithsej 183 familje me një fond 916,475 lekë.Është miratuar **P-V** shpërndarje fondi kontigjences dhe fondi rezerve në Buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2024.Është miratuar plani i aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Has për vitin 2025 bashkë me fondin e përcaktuar financiar. Është miratuar projekti i emergjencave civile për 2 qytetaret Agime Muja dhe Sabrije Pavdeja . Është miratuar **P-V** Për miratimin e bursave për nxënësit e

vitit të parë (1) që janë akomoduar në konviktin “Kosova” Krumë dhe vazhdojnë shkollën e mesme “Skënderbeu” Krumë, masa e bursës është 100% për vitin shkollor 2024-2025. Është miratuar **P-V** Për miratimin e bursave për nxënësit e vitit dytë (2) dhe tretë (3), që janë akomoduar në konviktin “Kosova” Krumë dhe vazhdojnë shkollën e mesme “Skënderbeu” Krumë, masa e bursës është 100%, për vitin shkollor 2024-2025. Është miratuar **P-V** për Miratimin e kalendarit të eventeve dhe datave historike të Bashkisë Has”, dhe mbulimin financiar të shpenzimeve nga Bashkia Has. Janë miratuar disa kërkesa të qytetarëve për ndihmë financiare :

1. Lulezim Morina 100,000 lekë.
2. Ali Kabashi 100,000 lekë.
3. Imer Kameraj 30,000 Lekë
4. Bashkim Thaçi 40,000 lekë
5. Arber Xhafa 200,000 lekë
6. Rustem Ukaj 100,000 lekë
7. Jetmir Sokoli 30,000 lekë.

Mbledhjet frekuentohen nga shumica e këshilltarëve. Ka një numër këshilltarësh që nuk marrin pjesë rregullisht në mbledhjen e këshillit dhe komisioneve duke penguar zhvillimin e mbledhjeve ku në disa raste mbledhjet janë shtyrë për këtë arsye. Edhe vonesat në fillimin e mbledhjeve mbeten një problem që duhet zgjidhur në vazhdimësi. I gjithë dokumentacioni i projektvendimeve të shqyrtuara gjatë mbledhjeve të Këshillit është publikuar në faqen eeb të këshillit për tu dhënë mundësi qytetarëve të njihen me to. Në regjistrin online për transparencën e mbledhjeve të këshillit janë dokumentuara të gjitha informacionet mbi mbledhjet duke filluar nga thirrja e mbledhjes, oraret e mbajtjes, videot e mbledhjes dhe proces verbalet tyre. Mbledhjet e Këshillit janë transmetuar online në facebook të Këshillit Bashkiak dhe në mediat lokale, të mundësuar nga bashkëpunimi me projektin Bashki të Forta (financuar nga Qeveria Zvicerane). Kjo i jep Këshillit Bashkiak një pavarësi në transmetimin pandërprerje livestream të mbledhjeve dhe i krijon mundësi të jetë transparent në lidhje me të gjitha vendimet që merr dhe problemet që trajton për ti ardhur në ndihmë qytetarëve. Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar mbledhjet e komisioneve të përhershme me pjesëmarrjen e këshilltarëve. Numrin më të madh të mbledhjeve e ka komisioni i përhershëm i Ekonomisë Financiare Pasurive Bashkiake Mbikëqyrjes Financiare Planifikimit dhe Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile Infrastrukturës Strehimit dhe Sherbimeve Publike e më pas Komisioni i Kulturës Arsimit e Sportit.

Roli mbikëqyrës.

Përveç ushtrimit të rolit vendimmarrës, Këshilli Bashkiak ka ushtruar dhe funksionin mbikëqyrës, duke kërkuar edhe informacione apo raporte nga administrata. Të tilla mund të

përmendim: 1.Raport nga Drejtoria e Shërbimeve Publike për masat e marra për nisjen e procesit mësimor dhe gjendjen e institucioneve arsimore publike 2.Raport nga Drejtoria e Ujësjellë-Kanalizimeve lidhur me situatën e furnizimit me ujë gjatë sezonit të verës. 3.Raport nga Drejtoria e Rrugëve lidhur me gjendjen e infrastrukturës në qytet si dhe njësitë administrative gjatë periudhës së dimrit. Gjithashtu, anëtarë të këshillit bashkiak kanë drejtuar kërkesa për informacion lidhur me probleme të veçanta.

Kërkesat dhe ankesat e qytetarëve.

Në total në Këshillin Bashkisë Has për periudhën Janar-Dhjetor 2024 janë regjistruar 58 kërkesa/ankesa të cilat janë trajtuar në mbledhjen e komisionit përkatës, ndërsa pjesa tjetër është trajtuar drejtpërdrejt nga Sekretari i Këshillit në bashkëpunim me drejtoritë. Pjesa më e madhe kërkesave ka qënë për emërtime rrugësh dhe kërkesa për informacion. Të gjitha kërkesat dhe ankesat janë të publikuara në regjistrin online të kërkesave-ankesave në faqen zyrtare të Këshillit Bashkiak.

Konsultimi me publikun.

Përfshirja e qytetarëve në procesin vendimmarrës është një prej elementëve përcaktues për një qeverisje të mirë. Ky detyrim buron nga ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Këshilli i ka kushtuar vemendje të veçantë dëgjësive publike për projektaktet për të cilat kërkohet nga ligji. Janë zhvilluar dëgjesa publike për disa projektakte: Dhënie pronash në përdorim, taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Has , projektbuxhetin afatmesëm 2025-2027 si dhe seanca konsultimi publik lidhur me buxhetin e vitit 2025. Në dëgjesa morën pjesë qytetarë, përfaqësues biznesesh, grupe interesi, anëtarë këshilli, të cilët kanë dhënë rekomandimet e tyre. Të gjitha informacionet për konsultimet e publikun janë të publikuara në regjistrin online për konsultimet me publikun në faqen e këshillit bashkiak.

Marrëdhëniet me Prefektin e Qarkut

Këshilli Bashkiak Has, në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ka dërguar pranë institucionit të prefektit për verifikim ligjshmërie të gjitha aktet me karakter normativ.

Asnjë akt nuk është kthyer për rishqyrtim. Gjithashtu, përfaqësues të institucionit të prefektit kanë kryer kontrollin e verifikimit të ligjshmërisë në vend, sipas parashikimeve ligjore.

Marrëdhëniet me administratën e bashkisë.

Sekretariati i Këshillit Bashkiak ka bashkëpunuar dhe koordinuar punën me administratën e bashkisë lidhur me projektaktet e paraqitura për miratim. Konstatohen problematika në lidhje me paraqitjen e projektvendimeve brenda afateve ligjore, mungesa të disa përfaqësuesve të drejtorive në mbledhjet e komisioneve apo mbledhjet e këshillit. Kërkohet një bashkëpunim më i madh në këtë aspekt.

Aktivitetet kryesore të Këshillit.

Gjate vitit 2024 Këshilli bashkiak, sipas planit vjetor të veprimtarive, ka realizuar mbledhjet e parashikuara dhe ato jashtë radhe, mbledhjet e komisioneve, seancat e komunikimit me publikun si dhe aktivitetet e tjera si trajnime të këshilltarëve, komisioneve, kryesisë së Këshillit, etj. Ndër aktivitetet kryesore të vitit 2024:

1. Ndjekja e procesit të zgjedhjeve të strukturave komunitare. Këshilli Bashkiak ka përcaktuar me vendim grafikun për zgjedhjet e strukturave komunitare në të gjitha njësitë administrative. Procesi është ndjekur nga përfaqësues të këshillit në çdo njësi. Zgjedhjet kanë përfunduar në shumicën e fshatrave dhe janë përsëritur në disa fshatra ku ka pasur ankesa për procesin. Në fshatrat ku zgjedhjet nuk janë zhvilluar për shkak të mospjesëmarrjes së banorëve, kryetarët e fshatrave janë emëruar nga Kryetari i Bashkisë.
2. Vizitë studimore e këshillit bashkiak Has në Angli (Wales) përkatësisht në Torfaen dhe Monmouthshire ku realizuam shkëmbim eksperiencash mes 3 këshillave bashkiake me fokus kryesor zhvillimin ekonomik dhe menaxhimin e mbetjeve urbane .
3. Trajnime të anëtarëve të komisioneve. Përgjatë vitit 2024, anëtarët e komisioneve kanë vijuar trajnimet, aktivitete kesto te mbeshtetura nga Bashki te Forta si dhe AMVV. Komisionet kryesore të trajnuara gjatë 2024 janë: Komisioni i Ekonomisë dhe Komisioni i Shërbimeve Publik.

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK HAS

Nezir LUSHI

HAS më 21/03/2025